

AUTO STAR ALBANIA sha

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

OPINIONI AUDITUESIT TE PAVARUR

1

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

3

PASQYRA E PERFORMANCËS

4

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

5

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE

6

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

7 – 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionerët e Shoqërisë "Auto Star Albania" sh.a

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "Auto Star Albania" sh.a (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjes së përshkruar në bazat për opinion me rezervë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Bazat për Opinion me Rezervë

Në Pasqyrën e performancës të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31.12.2016 janë përfshirë si të ardhura nga shitja e mallrave shuma prej 211,474,552 Lekë (shënimi 19) dhe kosto e mallrave të shitura shuma 198,247,811 Lekë (shënimi 21). Këto shuma përfaqësojnë shitje të një sasive mallrash të kontraktuara nga shoqëria të cilat janë bërë të disponueshme në muajin shkurt të vitit 2017. Dokumentimi i të ardhurave dhe i KMSH për këto mallra është kryer mbi bazën e pageseve të kryera gjatë vitit 2016 respektivisht të arkëtuara nga klienti dhe të paguara ndaj furnitorit. Këto pagesa nuk janë pasqyruar si parapagime të marra për shitjet apo parapagime të dhëna për blerje mallrash e për rrjedhojë rezultati i vitit ushtrimor dhe vlera kapitaleve të veta është rritur për shumën 13,226,741 Lekë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë Auto Star Albania sh.a për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015, kanë qenë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pakualifikuar mbi këto pasqyra më 31 mars 2016.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet. Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

  **MAZARS**
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al

Teit Gjini
Auditues Ligjor

31 korrik 2017

AUTO STAR ALBANIA sh.a
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	19,735,045	6,972,525
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	265,017,001	26,273,133
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	27	26,276,793	958,132
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	5,996,661	41,622,545
Inventarë	7	595,534,342	355,141,166
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	440,837	2,833,002
Totali i aktiveve afatshkurtra		913,000,679	433,800,503
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	1,311,483,874	1,128,920,629
Aktive afatgjatë jomateriale	10	5,914,883	-
Totali i aktiveve afatgjatë		1,317,398,757	1,128,920,629
Totali i aktiveve		2,230,399,436	1,562,721,132
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	605,293,055	260,374,402
Llogari të pagueshme tregtare	12	117,715,489	107,878,361
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	27	281,177,642	25,520,785
Detyrime tatimore	13	3,955,915	2,875,422
Parapagime të marra	14	31,732,282	19,652,047
Të tjera detyrime	15	5,487,710	11,225,803
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,045,362,093	427,526,820
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	16	67,380,975	16,587,998
Totali i detyrimeve afatgjatë		67,380,975	16,587,998
Totali i detyrimeve		1,112,743,068	444,114,818
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		1,140,000,000	1,140,000,000
Rezerva ligjore		6,294,988	6,294,988
Fitime të mbartura		(27,688,674)	(8,211,942)
Fitimi i ushtrimit		(949,946)	(19,476,732)
Totali i kapitalit		1,117,656,368	1,118,606,314
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	17	2,230,399,436	1,562,721,132

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	1,720,560,897	631,316,205
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	19,607,090	5,320,737
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(1,587,605,763)	(544,699,697)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	20	(1,514,632,124)	(498,103,058)
2) Të tjera shpenzime	21	(72,973,639)	(46,596,639)
Shpenzime të personelit	22	(96,735,646)	(90,729,149)
1) Paga dhe shpërblime		(86,899,707)	(83,386,998)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(9,835,939)	(7,342,151)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(41,323,130)	(11,324,852)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(964,243)	(140,832)
Shpenzime financiare	25	(8,618,488)	(7,485,302)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(16,371,266)	(13,095,244)
2) Shpenzime të tjera financiare		7,752,778	5,609,942
Fitimi/humbja para tatimit		4,920,717	(17,742,890)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(5,870,663)	(1,733,842)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	26	(5,870,663)	(1,733,842)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		(949,946)	(19,476,732)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(949,946)	(19,476,732)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AUTO STAR ALBANIA sh.a
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2015	1,138,968,481	6,294,988	1,031,519	25,253,715	(33,465,657)	1,138,083,046
Fitimi / Humbja e vitit						
Rritje kapitali	1,031,519		(1,031,519)		(19,476,732)	(19,476,732)
Tranferim në fitime të pashpërndara/ humbje të mbartura				(33,465,657)	33,465,657	-
Dividendë të paguar						-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	1,140,000,000	6,294,988	-	(8,211,942)	(19,476,732)	1,118,606,314
Fitimi / Humbja e vitit						
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:					(949,946)	(949,946)
Tranferim në fitime të pashpërndara/ humbje të mbartura				(19,476,732)	19,476,732	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	1,140,000,000	6,294,988	-	(27,688,674)	(949,946)	1,117,656,368

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i AUTO STAR ALBANIA sh.a më ___ mars 2017 dhe janë firmosur si më poshtë.

Florenc Pula
Hartues i pasqyrave financiare

Z.Musa Kastrati
 Administrator

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim/ Humbja e vitit	(949,946)	(19,476,732)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	1,795,270	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	41,323,130	11,324,852
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	320,263	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/ (rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(228,436,645)	58,296,682
Rënie/ (rritje) në inventarë	(228,473,370)	(115,906,272)
Rritje/ (rënie) në detyrimet e pagueshme	264,779,208	90,135,130
Rritje/ (rënie) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	2,392,165	(2,833,003)
Rritje/ (rënie) në parapagime të arkëtuara	12,080,235	4,459,185
Rritje/ (rënie) në detyrime për punonjësit	(5,738,093)	5,167,440
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(140,907,783)	31,167,282
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(244,185,940)	(27,388,775)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	2,144,613	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(242,041,327)	(27,388,775)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Rritje/(rënie) në huatë afatshkurtra	304,624,430	120,360,402
Ripagim/të hyrat neto nga huatë afatgjata	91,087,200	(130,906,739)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	395,711,630	(10,546,337)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	12,762,520	(6,767,830)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	6,972,525	13,740,355
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	19,735,045	6,972,525

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

AUTO STAR ALBANIA sh.a (Kompania) është themeluar si një shoqëri aksionare më 2 Gusht 1996 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë tregtare".

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 1,140,000,000 Lekë (një miliard e njëqind e dyzet milion Lek) dhe zotërohet nga:

- Basri Rruka me pjesëmarrje në përqindje 25%
- KASTRATI sh.a me pjesëmarrje në përqindje 75%

Veprimtaria kryesore e shoqërisë është importi, eksporti dhe tregtimi me shumicë apo pakicë të të gjitha llojeve të mjeteve motorike duke përfshirë importin e autoveturave, mjeteve të transportit të pasagjerëve, kamionëve dhe transportierëve të tij si dhe pjesë këmbimi.

NIPT-i i shoqërisë është J62023007G.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në autostradën Tiranë-Durrës, Km 7, godina 2 katëshe, nr 10.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3 Krahuesueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
EUR/LEK	135.23	137.28
USD/ LEK	128.17	125.79

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim / humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë kostot e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali i nënshkruar

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Aktive afatgjata material (vazhdim)

ii. *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %

iv. *Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. MJETE MONETARE

Mjetet monetare në lekë dhe në valutë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Mjete monetare në bankë	18,069,449	696,471
Në lekë	7,016,014	528,343
Në monedhë të huaj	11,053,435	168,128
Mjete monetare në arkë	1,665,596	6,276,054
Në lekë	1,089,850	5,977,743
Në monedhë të huaj	575,746	298,311
	19,735,045	6,972,525

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Klientë për mallra	265,017,001	26,273,133
	265,017,001	26,273,133

6. TË TJERA LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
TVSH e arkëtueshme	1,184,148	28,072,305
Tatim mbi fitimin i parapaguar	-	4,075,393
Të tjera llogari të arkëtueshme	4,812,513	9,474,847
	5,996,661	41,622,545

7. INVENTARË

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Automjete për rishitje	438,426,988	234,722,126
Pjesë këmbimi	157,107,354	120,419,040
	595,534,342	355,141,166

8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Shpenzime të shtyra	440,837	2,833,002
	440,837	2,833,002

AUTO STAR ALBANIA sh.a

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2016

Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

<i>Kosto</i>	Toka	Ndërtim, instalime të përgjithshme	Instalime teknike, makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Pajisje zyre dhe orendi	Të tjera	Aktive në proces	Parapagime për asete	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	616,000,000	624,113,363	137,819,408	28,055,690		19,803,437	2,044,223			1,427,836,121
Shtesa			274,491		1,558,631	1,033,940		24,521,713		27,388,775
Nxjerrje jashtë përdorimit										-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	616,000,000	624,113,363	138,093,899	28,055,690	1,558,631	20,837,377	2,044,223	24,521,713	-	1,455,224,896
Shtesa		866,000	9,652,664		736,643	24,621,203	102,000	191,683,060	10,330,500	237,992,070
Transferime në inventar								(11,919,806)		(11,919,806)
Transferime		13,391,907						(13,391,907)		-
Dalje				(3,049,056)	(440,233)					(3,489,289)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	616,000,000	638,371,270	147,746,563	25,006,634	1,855,041	45,458,580	2,146,223	190,893,060	10,330,500	1,677,807,871
<i>Amortizimi i akumuluar</i>										
Gjendja më 1 janar 2015	-	227,322,825	56,908,127	13,360,519		16,566,036	821,908	-	-	314,979,415
Amortizimi i vitit		6,197,974	1,310,187	2,939,032		833,028	44,631			11,324,852
Nxjerrje jashtë përdorimit										-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	233,520,799	58,218,314	16,299,551	-	17,399,064	866,539	-	-	326,304,267
Amortizimi i vitit		19,752,827	17,401,455	1,956,939	363,854	1,473,430	95,637			41,044,142
Nxjerrje jashtë përdorimit				(857,099)	(80,569)		(86,744)			(1,024,412)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	253,273,626	75,619,769	17,399,391	283,285	18,872,494	875,432	-	-	366,323,997
<i>Vlera neto kontabël</i>										
Gjendja më 31 dhjetor 2015	616,000,000	390,592,564	79,875,585	11,756,139	1,558,631	3,438,313	1,177,684	24,521,713	-	1,128,920,629
Gjendja më 31 dhjetor 2016	616,000,000	385,097,644	72,126,794	7,607,243	1,571,756	26,586,086	1,270,791	190,893,060	10,330,500	1,311,483,874

10. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	AAJM	TOTALI
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2015	-	-
Shtesa	-	-
Transferime	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	-
Shtesa	6,193,871	6,193,871
Transferime	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	6,193,871	6,193,871
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2015	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	-
Amortizimi i vitit	278,988	278,988
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	278,988	278,988
Gjendja neto më 31 dhjetor 2015	-	-
Gjendja neto më 31 dhjetor 2016	5,914,883	5,914,883

11. HUA AFATSHKURTRA

Balanca e llogarive afatshkurtra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Overdraft Raiffeisen Bank	235,661,166	-
Kredi qarkulluese Tirana Bank	315,897,280	247,104,000
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	53,564,625	13,270,402
Interesa te perlllogaritura	169,984	-
	605,293,055	260,374,402

12. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari të pagueshme tregtare	116,944,959	107,878,361
Furnitorë për fatura të pambërritura	770,530	-
	117,715,489	107,878,361

13. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,431,392	1,176,255
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	729,253	1,074,284
Tatim në burim	-	624,883
Tatim mbi fitimin	1,795,270	-
	<u>3,955,915</u>	<u>2,875,422</u>

14. PARAPAGIME TË MARRA

Parapagimet e marra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime të marra	31,732,282	19,652,047
	<u>31,732,282</u>	<u>19,652,047</u>

15. TË TJERA DETYRIME

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Paga për t'u paguar	5,487,710	11,225,803
	<u>5,487,710</u>	<u>11,225,803</u>

16. HUA AFATGJATA

Huatë afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Pjesa afatgjatë e huasë Raiffeisen Bank	64,112,969	-
Pjesa afatgjatë e huasë Tirana Bank	3,268,006	16,587,998
	<u>67,380,975</u>	<u>16,587,998</u>

17. KAPITALI

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 1,140,000,000 Lekë (një miliard e njëqind e dyzetë milionë Lekë) dhe dhe zotërohet nga:

Basri Rruka me pjesëmarrje në përqindje 25%
KASTRATI sh.a me pjesëmarrje në përqindje 75%

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Numri i aksioneve	114,000	114,000
Vlera nominale	10,000	10,000
	1,140,000,000	1,140,000,000

Rezervat ligjore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë 6,294,988 Lekë (2015: 6,294,988 Lekë).
Fitimet e mbartura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë (27,688,674) Lekë (2015: (8,211,942) Lekë).

18. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga shitja e automjeteve	1,298,363,359	397,282,140
Të ardhura nga shërbime dhe pjesë këmbimi	422,197,538	234,034,065
	1,720,560,897	631,316,205

19. TË ARDHURA TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga qiraja	1,629,750	-
Rezultati neto nga shitja e aktiveve	(311,283)	-
Të ardhura/(shpenzime) nga këmbimet valutore neto	(2,498,013)	-
Të ardhura të tjera	20,786,636	5,320,737
	19,607,090	5,320,737
	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Të ardhura nga shitja e aktiveve	2,144,613	-
Vlera kontabël neto e aktiveve të shitura	(2,455,896)	-
Rezultati Neto nga shitja e AAM-ve	(311,283)	-

20. LËNDË TË PARA DHE MATERIALE TË KONSUMUESHME

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Kosto e mallrave të shitur	1,514,632,124	498,103,058
	<u>1,514,632,124</u>	<u>498,103,058</u>

21. TË TJERA SHPENZIME

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Blerje energji, avull, ujë karburant	7,492,651	4,836,286
Blerje të ndryshme, kancelari etj	946,543	581,061
Mirëmbajtje dhe riparime	9,114,609	1,596,230
Sigurime	957,776	899,110
Shpenzime për pritje përcjellje	6,249,089	253,980
Transferime, udhëtime, dieta	4,004,283	6,174,496
Shpenzime informatike	7,670,909	4,997,054
Shërbime nga të tretë	2,450,339	4,897,359
Shpenzime doganore	1,991,831	-
Uniforma për punonjësit	1,077,174	-
Shpenzime marketingu dhe sponsorizime	949,004	2,186,787
Taksa të ndryshme	15,888,147	3,350,796
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	2,055,720	2,356,650
Shërbime bankare	4,462,063	1,414,763
Humbje nga shitja nën kosto	3,805,915	12,377,761
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	3,398,890	300,032
Shpenzime të tjera	458,696	374,274
	<u>72,973,639</u>	<u>46,596,639</u>

22. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për paga	86,899,707	73,271,100
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	9,835,939	7,342,151
Shpenzime të tjera për personelin	-	10,115,898
	<u>96,735,646</u>	<u>90,729,149</u>

23. SHPENZIME KONSUMII DHE AMORTIZIMI

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime amortizimi	41,323,130	11,324,852
	<u>41,323,130</u>	<u>11,324,852</u>

24. SHPENZIME TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Gjoha dhe dëmshpërblime	964,243	140,832
	<u>964,243</u>	<u>140,832</u>

25. SHPENZIME FINANCIARE

Shpenzimet financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për interesa	(16,371,266)	(8,924,408)
Të ardhura nga interest	-	269
Interesa për garanci	(2,233,783)	(4,171,105)
Fitime/(humbje nga këmbimet valutore)	9,986,561	5,609,942
	<u>(8,618,488)</u>	<u>(7,485,302)</u>

26. SHPENZIMI AKTUAL I TATIMIT MBI FITIMIN

Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
<i>Fitimi para tatimit</i>	4,920,717	(17,742,890)
<i>Total shpenzime të panjohura</i>	34,217,037	29,301,837
Shpenzime pritje percjellje	1,028,585	-
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	964,243	140,832
Humbja nga shitja e AAM-ve	311,283	-
Shpenzime amortizimi	28,514,036	-
Shpenzime të tjera	3,398,890	29,161,005
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	39,137,754	11,558,947
 <i>Tatim fitimi @15%</i>	 5,870,663	 1,733,842
	(949,946)	(19,476,732)

27. PALËT E LIDHURA

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
<i>Huamarrje</i>	-	71,765,002	-	15,238,080
Kastrati sh.a	-	71,765,002	-	15,238,080
	26,276,793	209,412,640	958,132	10,282,705
Kastrati sh.a	19,420,881	187,281,600	651,804	79,158
KST Advertising sh.p.k	73,500	-	-	206,137
Lindi sh.p.k	-	-	-	-
Alb Siguracion	6,730,835	7,381,137	111,220	441,430
Continental Group	51,577	5,593,903	165	399,980
Kastpetrol sh.a	-	9,156,000	194,943	9,156,000
	26,276,793	281,177,642	958,132	25,520,785

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Kastrati sh.a	270,400,984	133,744,619	11,367,483	79,158
KST Advertising sh.p.k	1,888,932	14,232	-	206,140
Lindi sh.p.k	-	162,166	-	-
Alb Siguracion	24,337,034	693,610	8,784,549	647,485
Continental Group	278,175	7,065,820	374,579	383,647
Kastpetrol sh.a	23,532	-	713,582	7,630,000
	296,928,657	141,680,447	21,240,193	8,946,430

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

28. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

29. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT FINACIAR

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

MAZARS SHPK

Address: Rruga Emin Duraku,
Pall. Binjaket, No.5
Tirana, 1000
Tel. +355 4 222 2889
Fax. +355 4 222 2889

www.mazars.al